Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

\* “Përmbushja e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit.

Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme”

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimi i ofertes, (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;
- b. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;
- ç. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.  
*(Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveçrastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik)*
- dh. Formularin e informacionit konfidencial

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 3.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

#### Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Sherbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, **nënkategoria 1.3.A**, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL;
2. Çertifikatë e drejtuesit teknik dhe titullarit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit "Ruajtja dhe Sigurimi fizik i objekteve dhe pronave" në bazë të ligjit nr 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë“ për nënkategorinë 1.3.A;
3. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 63 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë; përfshirë titullarin dhe drejtuesin teknik të shoqërisë  
- Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore , i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emerore të punonjesve të shërbimit të certifikuar dhe vlefshmerine e ketyre certifikatave – datën e certifikimit ( datën e lëshimit) , si edhe afatin e vlefshmerise se kesaj certifikate.

### 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit të operatorit ekonomik pjesëmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatesë dhe të konfirmuara nga ky autoritet.
- b) Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të



fundit ku vlera mesatare e tyre të jete sa vlera 40% e Marreveshjes Kuader.

### 3.3 Kapaciteti teknik:

1. Shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të marra së bashku, në një vlerë sa 40 % të fondit limit.

- Kur shërbimi i ngjashëm është i realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e realizimit të lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate. ose
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit të Qarkut Tirane, si dhe Dokumenti i Performances mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik

Për këtë duhet të paraqesë **vertetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut** ku jepet informacioni i mesipër i kërkuar.

3. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit, shoqëruar me **listë pagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **65 punonjës** të siguruar në muaj.

4. Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi Tirane.

5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **analizen e kostos për ofertën e paraqitur**. (Shih **Shtojca 1 - Sqarime**)

6. Operatori ekonomik duhet të ketë qendër kontrolli funksionale të miratuar nga Policia e Shtetit si :

a. jo më pak se 63 punonjës shërbimi (me certifikatat përkatëse dhe listen emerore )

b. salla operative (drejtimi) dhe adresën përkatëse të saj

c. Nuk ka mase administrative gjatë vitit të fundit

\* Për sa më lart të provohen me paraqitjen e vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tirane.

7. CV të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës.

8. Subjektet e SHPSF-së duhet të provojnë se, disponojnë mjete dhe pajisje teknike për të përmbushur objektin e kësaj kontrate si më poshtë:

Nr.	Emertimi i pajisjeve	Sasia	Disponibiliteti
1.	Radio nderlidhje	21 cope	ne pronesi ose me qera
2.	Automjete	2 cope	ne pronesi ose me qera

- i. Për pajisjet, nëse janë në pronësi, duhet të paraqitet fatura tatimore e shitjes.
- ii. Për pajisjen, nëse është me qera, duhet të paraqitet kontrata e qirasë dhe fatura tatimore e shitjes.
- iii. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (certifikata e pronësise, leje qarkullimi, police sigurimi dhe kontrolli teknik).
- iv. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qirase si dhe dokumenti që vërteton regjistrimin (certifikata e pronësise, leje qarkullimi, police sigurimi dhe kontrolli teknik).

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**



# Public Health Sector

## Shtojca 8

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]

### DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula



# Public Health Sector

Shtojca 9

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### SPECIFKIMET TEKNIKE

Operatori ekonomik i licënuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në bazë të Ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, ka disa përgjegjësi kryesore, si:

## Dokumentat standarde të tenderit

1. Të mbulojë të gjitha shpenzimet, si: pagat e rojeve, sigurimet shoqërore të personelit të punësuar nga ana e tij për ruajtjen e objekteve, shpenzimet për uniformat, ndërlidhje, si dhe gjithë kompesimet e tjera, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Sigurimi i rendit dhe qetësisë në objektet që ruan duke informuar në kohë strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe të sigurojë bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë publike në territorin e objektit në ruajtje;
3. Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.
4. Të ushtrojë kontroll të herëpashershëm të personave që hyjnë në territorin e objekteve që ruhen, si dhe automjeteve në territorin e saj;
5. Të kërkojë zbatimin e rregullave të përcaktuara nga punëdhënësi, si dhe rregulloreve të brendshme të nxjerra nga ky i fundit, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kësaj kontrate;
6. Të informoje rregullisht Autoritetin Kontraktor, për problematikat e konstatuara duke i dokumentuar ato.
7. Sipërmarrësi mban përgjegjësi për dëmtimet apo vjedhjet që mund të ndodhin jo vetëm në godinat spitalore dhe vendrojet përkatëse, por edhe në të gjitha objektet e tjera që janë pjesë e territorit të QSUT-së dhe janë objekte të QSUT-së, në territorin e objektit që ruhet nga ana e tij, si dhe në sipërfaqet e gjelbërta, kur këto vijnë si rezultat i mungesës së vigjilencës së rojeve dhe mos organizimit të mirë të shërbimit. Në këto raste sipërmaresi detyrohet të bëjë ç'dëmtimin e pasurisë së vjedhur apo dëmtuar në masën 100% të vlerës së dëmtuar.
8. Të marrë masat e nevojshme për sigurimin teknik në lidhje me **armët dhe municionet**, mjetet e shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi;
9. Të mos punësojë në veprimtarinë e SHPSF-së punonjës shërbimi të paçertifikuar;
10. Të përdorë aktivitetin e SHPSF-së vetëm për qëllimin për të cilin është licencuar;
11. Të plotësojë kushtin e Nenit 22 “Qendra e kontrollit të SHPSF-së” të ligjit 75/2017:
  - 1. Subjekti i licencuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari, duhet të ketë qendër kontrolli, ku të tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emërtimin e shoqërisë.
  - 2. Qendra e kontrollit të shërbimit kryen detyrat e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.
  - 3. Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë. Përqëndrimi i valëve, të jetë në një valë të vetme, ku QSUT duhet të vihet në dijeni për çdo informacion që përcillet në këtë valë;
12. Çdo vendroje të jetë e paisur me radiomarrëse.

Gjithashtu, operatori ekonomik në ushtrimin e aktivitetit të shërbimit privat të sigurisë fizike, duhet të ketë personelin kryesor si **Drejtuesin Teknik dhe Punonjësit e Shërbimit (rojet)** me detyrat përkatëse:

- Të ketë **drejtues teknik të licencuar** për ushtrim aktiviteti.

Në bazë të ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” drejtuesi teknik i SHPSF-së, ndër të tjera kryen këto detyra:

**a)** harton rregullat e funksionimit të SHPSF-së, në lidhje me ruajtjen e objektit;

**b)** është përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe siguron

- bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje;
- c) ka përgjegjësinë të konstatojë dhe të analizojë të metat e dobësitë e punonjësit të shërbimit, t'ua bëjë ato të njohura administratorit dhe strukturave vendore të Policisë së Shtetit, si dhe të marrë masa për shmangien dhe përmirësimin e tyre;
- ç) jep masa disiplinore ndaj punonjësit të shërbimit, sipas kuptimit të këtij ligji;
- d) parandalon planifikimin në shërbim të punonjësit të papajisur me uniformë, armatim dhe pajisje shërbimi;
- dh) merr masa për ruajtjen e vendit të ngjarjes, në rastin kur ndodh një vepër penale në territorin e objektit që ka në ruajtje, duke njoftuar Policinë e Shtetit dhe duke bashkëpunuar me të.

**Specifikimet për punonjësit e shërbimit(rojet), referuar Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”**

- Të jenë të aftë fizikisht;
- Të jenë të licencuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut;
- Të jenë të pajisur me uniformë të rregullt (në bazë të nenit 23, të ligjit nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” uniforma e punonjësit të shërbimit të SHPSF-së mbahet dhe përdoret vetëm gjatë kryerjes së shërbimit, si dhe në uniformë duhet të vendosen, sipas përkatësisë, shenjat dalluese, emblemat, stemat, numri identifikues, të cilat tregojnë identitetin e subjektit dhe të punonjësit të shërbimit);
- Të jenë të pajisur me radio komunikim, i cili duhet të jetë i lidhur me sistemin qendror të komunikimit me radio;

*Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:*

- a-Rregullorja e brendshme
- b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.
- c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.
- d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.
- e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.
- f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

- Të kenë të drejtën e mbajtjes e përdorimit të armëve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të kenë leje për armë;
- Të zbatojnë me korrektësi detyrat për ruajtjen e objekteve spitalore, godinave teknike të gazrave mjekësore dhe lëndës djegëse, godinës së farmacisë qendrore dhe depove përkatëse të saj, farmacive periferike, godinën e telemjekësisë, sipërfaqeve të gjelbërta dhe bimësisë, si dhe ruajtjen e të gjithë territorit të QSUT-së, si sipërfaqet e gjelbërta nga ndotjet, dëmtimet, vjedhjet apo abuzimet e tjera të mbajë lidhje të vazhdueshme me drejtuesin teknik;
- Të zbatojnë me korrektësi detyrat për, zbatimin e orarit të vizitave në pavion/godinat spitalore, dhe të moslejimit të qytetarëve për kryerjen e konsultave ambulatorë në pavion, përvec Godinës së Qendrës së Konsultave, Godina e Konsultave e Neuroshkencës, Godina e Konsultave të Neurologjisë, Godina e Konsultave e Pediatriisë, Godina e Konsultave të Spitalit Francez.
- Të zbatojnë rregulloren e brendshme të miratuar;
- Të zbatojnë me korrektësi cdo urdhër të titullarit të A.K., apo kërkesë të dalë prej A.K.
- Të mbajnë, sipas rregullores, armatimin personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën,

shenjat dhe simbolet e SHPSF-së, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi;

- Të kryejnë detyrat për ruajtjet e vendit të ngjarjes në territorin e shërbimit, të bëjë identifikimin e personave që lidhen me ngjarjen dhe të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit për hetimin e ngjarjes në objektin që siguron;

- Të mos vendosin në uniformë dhe në mjetet e transportit simbole apo shenja të tjera, përveç atyre të miratuara nga ky ligj;

- Të kenë kodin etik për komunikim dhe sjellje qytetare, si dhe të mos përdorë pije alkoolike, droga e lëndë narkotike në shërbim.



## Shtojca 10

# Public Health Sector

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër ]

### PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Shërbim:                      Mall:                      Punë:		
Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>

01		
02		
03		
...		



Shtojca 11

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet: Objekti:** “Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike të Objekteve dhe Godinave, Sipërfaqeve të Gjellbërta dhe Bimësisë, të QSUT” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.

**Afatet e ekzekutimit:** 12 muaj ( i parashikuar)

**Vendndodhja e shërbimit:** Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i levrimit
--------------------	-----------------	-----------------------------	------------------

<b>21</b>	<b>3</b>	<b>4.98</b>	<b>12 muaj</b> <i>Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.</i>
-----------	----------	-------------	---



Shtojca 12

**TERMAT E REFERENCËS**

# Public Health Sector

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

**“Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike të Objekteve dhe Godinave, Sipërfaqeve të Gjelbërta dhe Bimësisë, të QSUT” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.**

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

Detyrat:



Personeli i ngarkuar në shërbim, i vendosur në vendrojet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duhet të zbatojë me rigorozitet **TERMAT E REFERENCËS**, si më poshtë:

- Rregulloren e Brëndshme të QSUT-së (përfshi këtu të shërbimeve);
- Rregulloren e Brëndshme mbi shërbimin e rojeve për ruajtjen dhe sigurimin e objektit të QSUT-së;
- Vendimin Nr.877, date 30.10.2015 për miratimin e rregullores “Për Sigurimin e Burimeve Radioaktive në Republikën e Shqipërisë”. O.E. fituses, duhet të paraqesë në momentin e lidhjes së kontratës planin zbatues si do funksionojë kjo rregullore nga punonjësit e shërbimit në vendrojet e godinave ku punohet me materiale radioaktive.
- Të Respektojë orarin e vizitave të miratuara, pjesë të rregullores, në të gjitha godinat spitalore, ku : të mos lejojë asnjë hyrje – dalje të familjarëve në pavione, përveç gjatë orarit të vizitave të miratuara, dhe vetëm nga një person për familjar dhe jo prezencën e fëmijëve nën 16 vjeç;
- Të sigurojë gjithashtu, që gjatë orarit të vizitave të mos lejojnë hyrjen e çantave të mëdha, valixheve në dhomën e pacientit;
- Të sigurojë të gjitha godinat spitalore, dhe përreth territorit të tyre sipas vendrojeve të përcaktuara në tabelë.
- Të sigurojë objektet e tjera, pjesë e territorit të QSUT-së, ku përveç godinave spitalore janë të rëndësishme në QSUT, si : farmacitë periferike, farmacinë qendrore, depot e QSUT-së, tankerat e oksigjenit, depon qendrore të ujit, depon qendrore të kaldajës, motogjeneratorët, depot teknike, magazinën e konsumit, magazinën e inventarit, godinën e telemjekësisë, mjetet e transportit të QSUT-së (autoambulancat), shtyllat e larta të ndricimit, si dhe ndricimin e ulët pjesë e territorit të QSUT-së, sipërfaqet e gjelbërta, pemët dhe bimësisinë që gjendet në të;
- Të sigurojë, mos lejimin e asnjë personi apo personeli të paautorizuar nga Drejtoria, në të gjitha godinat spitalore dhe jo spitalore, përveç personave të stafit të administratës, teknik, shëndetësor, mjekëve specializantë, të cilët: vetëm nëse do të jenë të pajisur me dokument identifikues të Drejtorisë së QSUT-së mund të aksesojnë hyrjen;
- Të sigurojë, mosdëmtimin e sipërfaqeve të gjelbërta të territorit të QSUT-së dhe të pemëve dhe bimësisë që gjendet në të, të cilat mirëmbahen nga operatorë të kontraktuar, të cilat do i lihen me proces verbal në momentin e lidhjes së kontratës;
- Çdo ditë në orën 22:00 në pavionet mjekësore, personeli në shërbim duhet të mbyllë derën kryesore të godinës ku kryen shërbimin, dhe të kontrollojë të gjitha dyert e pavioneve apo dyerve të tjera në shërbim, duke marrë konfirmimin e personelit infermioror përgjegjës të turnit dhe mbylljen e dritave, si dhe të sigurojë moslejimin e personave të paautorizuar gjatë gjithë kohës;
- Të mos lejojë parkimin e mjeteve para hyrjes kryesore të godinave spitalore, si dhe të ruajë sipërfaqet e parkimit të QSUT-së;
- Të mbështesë gjithmonë personelin infermioror sa herë që kërkon ndihmë;
- Gjatë gjithë kohës personeli që është në shërbim, përveç veshjes duhet të mbajë dokumentin e identifikimit;
- Të komunikojë me etikë si me qytetarët, pacientët ashtu dhe me personelin infermioror gjatë gjithë kohës së shërbimit, dhe mos të japë informacion të paautorizuar.
- Është e rëndësishme që në QSUT, duhet të krijohet një patrullë në qarkullim, e cila do

Dokumentat standarde të tenderit

qarkullojë gjatë gjithë kohës në territorin e QSUT-së, për t'iu përgjigjur të gjitha problematikave që hasen në shërbimet spitalore, si dhe për të mos lejuar ambulatorë të ndryshëm, lypsarë, etj;

- Të mos lejojnë në mënyrë kategorike, hyrjen e agjensive private funerale brenda shërbimeve spitalore.

Shpërndarja:

Nr.	Vendrojet	Koef. i mbulimit	Mbulimi me roje i objekteve		
			t. I	t. II	t. III
1	Ndërtesa e Drejtorisë	4.98	1	1	1
2	Spitali 6 katësh	4.98	1	1	1
3	Shërbimi i Toksikologjisë	4.98	1	1	1
4	Kardio - Kirurgjia	4.98	1	1	1
5	Kirurgjia Klinika e parë	4.98	1	1	1
6	Kirurgjia Kl. II (Urologjia) + Kl. III (Digjестive)	4.98	1	1	1
7	Urgjenca Kirurgjikale	4.98	1	1	1
8	Urgjenca e Sëmundjeve të Brendëshme	4.98	1	1	1
9	Reanimacioni Qëndror + Mjekësia Interne	4.98	1	1	1
10	Hyrja kryesore e Spitalit të Neurokirurgjisë	4.98	1	1	1
11	Spitali i Neurokirurgjise	4.98	1	1	1
12	Spitali i Neurologjisë	4.98	1	1	1
13	Hyrja Kryesore e Sp të Psikiatrisë + Aksilatori i Neurokirurgjisë + Urgjenca e Psikiatrisë + Psikiatria Infantile	4.98	1	1	1
14	Spitali Infektiv	4.98	1	1	1
15	Spitali Onkologjik	4.98	1	1	1
16	Radio - Terapi Onkologjiku	4.98	1	1	1
17	Spitali Francez	4.98	1	1	1
18	Spitali Djegie Plastikës+ Dermatologji	4.98	1	1	1
19	Spitali Pediatrikë së Specialiteteve	4.98	1	1	1
20	Pediatria e Pergjithshme	4.98	1	1	1

21	Qendra e Konsultave Ambulatore	4.98	1	1	1
----	--------------------------------	------	---	---	---

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë**



**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

## **NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>** **Public Health Sector**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

## Dokumentat standarde të tenderit

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >



# Public Health Sector

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e

suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]



# Public Health Sector

## Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR


[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_



Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

Public Health Sector

Dokumentat standarde të tenderit

Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Drejtuuesi i autoritetit kontraktor]



## Shtojca 16

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES** **Shërbimet – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1 Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2 Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3 Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit

të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigura.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

#### **Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

